



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4228/1 Prot.,

Shkodër, më 16/03/2021

Lënda: Dërgim informacioni dhe dokumentacioni në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 392/2 Protokolli, datë 09.03.2021

KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, kati 1, Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të Vendimit nr.392/2 Protokolli, datë 09.03.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, administruar në bashkinë Shkodër me nr. 4228, datë 12.03.2021, Ju informojmë si vijon:

Autoriteti Shitës, Bashkia Shkodër në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar, ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 " Për ankandin Publik" , të ndryshuar, VKM 1719, datë 17.12.2008 " Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, vendimit të Këshillit Bashkiak nr.54, datë 27.11.2020 "Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a, në masën 100%", ka shpallur procedurën e ankandit publik me këto të dhëna :

1. Autoriteti shitës : Bashkia Shkodër
2. Data e zhvillimit te ankandit : 09.03. 2021 , ora 10.00.
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Procedurë e hapur
4. Objekti i Shitjes: Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" sh.a, në masën 100%.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Klubi i futbollit Vllaznia sh.a, është shoqëri e organizuar në formën e shoqërisë aksionare, e krijuar në vitin 2011, ku aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Shkodër. Në mënyrë më të zgjeruar objekti i shitjes përshkruhet në Shtojcën 10, Specifikimet teknike.
6. Vlera fillestare: 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: Bashkia Shkodër, Rruga 13 Dhjetori, nr 1.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: data 09.03.2021, ora 10.00.

9. Informacionet mbi dokumentet e ankandit: Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë Autoritetit Shitës.

Njoftimi i këtij ankandit është publikuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik në buletin nr.21, datë 15 Shkurt 2021 ¹.

Njësia e Ankandit në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka miratuar kriteret për kualifikim dhe dokumentet e ankandit.

Njësia në hartimin e kriterëve për kualifikim ka marrë parasysh dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fushën e ankandit publik, sportit, sponsorizimeve si dhe atë të prokurimeve publike.

Ndodhur në kushtet kur, legjislacioni për ankandin nuk ka parashikuar në mënyrë specifike kriteret të veçanta për kualifikimin e ofertuesve, njëkohësisht si Autoritet Shitës nuk kemi procedura të ngjashme ankandi, ju jemi referuar parashikimeve ligjore të bëra në fushën e prokurimit publik si dhe Vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, si institucioni kompetent sipas ligjit për shqyrtimin e vendimmarrjen së autoriteteve shitese ne procedurën e ankandit publik. (VKPP nr. 752/2017; nr. 35/2019 si dhe 147/2019)

Kriteret e veçanta për kualifikim janë vendosur me qëllimin e vetëm për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësive që kandidatët kanë për përmbushjen me sukses të kontratës. Sipas specifikave që ka ky ankand pulik dhe aktivitetit të shoqërisë tregtare Klubi i Futbollit “Vllaznia” sha, me qëllim që të krijohet bindja apo siguria e përmbushjes së objektivave teknike, financiare, njerëzore, si dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiveve sportive, nga subjektet kandidatë ofertues/blerës, kemi përcaktuar kërkesa të veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga subjektet e interesuara në këtë procedurë ankandi, në mënyrë që të garantohet vazhdimësia, qëndrueshmëria, efçensa dhe përmbushja e objektivave sportive të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a edhe në vijim pas procesit të privatizimit.

Vlen të theksohet se ligji i posaçëm për ankandet publike nuk parashikon asnjë dispozitë me anë të së cilës kufizon autoritetet shitëse të përcaktojnë kriteret e veçanta të kualifikimit, që gjykojnë se janë të nevojshme për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës, për sa kohë këto kriteret nuk tejkalojnë objektin dhe volumin e saj.

Kriteret e veçanta për kualifikim të miratuara nga njësia e ankandit, janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të kandidatëve blerës, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Subjekti sh.p.k. ka tërhequr dokumentacionin e ankandit pranë autoritetit shitës bashkia Shkodër, nepërmjet personit të autorizuar për terheqjen e dokumenatcionit z.... sipas procesverbalit nr. 3332/1.prot, datë 25.02.2021.

¹ Bashkia Shkodër ka dërguar për publikim pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, shkresën nr.1973.prot, datë 02.02.2021 me lëndë “Dërgim njoftimi te ankandit”, duke parashikuar publikimin në datë 08.02.2021 dhe datë zhvillimi ankandi datën 01.03.2021, ora 10.00, pas verifikimit në datë 08.02.2021, rezultoi që njoftimi i ankandit nuk është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte është përcaktuar data e re 09.03.2021, ora 10.00, për njoftimin dhe zhvillimin e procedurës së ankandit.

Me datë 01.03.2021, autoriteti shitës ka administruar shkresën nr.3543.protokolli hyrës, me lëndë "Formulari i ankesës", të subjektit sh.p.k, me administrator z. ...

Në zbatim të nenit 42, pika 3 të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 " Për ankandin Publik" , të ndryshuar dhe kreut VIII, pika 8, germa ç të VKM 1719, datë 17.12.2008 " Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, autoriteti shitës me vendimin nr. 79, datë 01.03.2021, ka pezulluar procedurën e ankandit publik, me objekt " Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia", sh.a në masën 100%, deri në shqyrtimin përfundimtar të ankesës nr. 3543, datë 01.03.2021.

Njëkohësisht është caktuar dhe personi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës, autoriteti shitës i ka kthyer përgjigje ankuesit nepërmjet shkresës nr.3543/2, datë 02.03.2021 "Kthim përgjigje ankesës të administruar në bashkinë Shkodër nr. 3543 prot, datë 01.03.2021, duke refuzuar ankesën e paraqitur nga subjekti sh.p.k.

Me datë 05.03.2021 në Bashkinë Shkodër është administruar shkresa nr. 3878 prot., me lëndë "Formulari i ankesës" e subjektit sh.p.k, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe për dijeni Bashkisë Shkodër.

Faza e procedurës: E pezulluar deri në shqyrtimin e ankesës së subjektit sh.p.k nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 3878, datë 05.03.2021.

Sa i takon pretendimeve të subjektit ankues të paraqitura nëpërmjet ankesës nr. 3543 protokoli hyrës, datë 01.03.2021, autoriteti shitës, Bashkia Shkodër vlerëson se:

- ka parashikuar kriteret të cilat janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për ankandin publik, në fushën e sportit, me ligjin e procedurave tatimore si dhe ligjin për sponsorizimet.
- kriteret e vendosura nga njësia e ankandit, e ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- shqyrtimi i ankesës dhe argumentimi ligjor kundrejt pretendimeve të ankuesit, është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr.3543/2, datë 02.03.2021 "Kthim përgjigje ankesës të administruar në bashkinë Shkodër nr. 3543 prot, datë 01.03.2021.

Për sa u trajtua më sipër, në zbatim të vendimit Tuaj nr.392/2 Protokoli, datë 09.03.2021 në cilësinë e dokumentacionit provues bashkëlidhur ju dërgojmë :

- Dokumentat standarte të ankandit shoqëruar me procesverbalin i njësisë së ankandit dhe Ankesin 1, bashkëlidhur tij.
- Shkresën nr.3543.protokolli hyrës në bashkinë Shkodër, datë 01.03.2021 me lëndë "Formulari i ankesës", të subjektit sh.p.k,
- Shkresë e bashkisë Shkodër nr.3543/2, datë 02.03.2021 "Kthim përgjigje ankesës të administruar në bashkinë Shkodër nr. 3543.prot, datë 01.03.2021",

- Shkresë e bashkisë Shkodër nr. 3906 prot., datë 05.03.2021 “Kërkesë për lëshim udhëri të ndërmjetëm, për lejimin e autoritetit shitës bashkia Shkodër të vazhdojë procedurën e ankandit publik me objekt: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia”, sh.a në masën 100%,
- Dërgim i njoftimit të ankandit me nr. 2332 prot., dt. 08.02.2021,
- Buletini me nr. 21, dt. 15.02.2021, fq. 348-349.

Duke Ju falenderuar,

KRYETAR

Voltana Ademi

